



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Ac.nr.974/16**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Gani Avdiu e Arsim Hamzaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J. (I) K. nga Peja, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.H.I. nga Peja, kundër të paditurës Komuna e Pejës – Drejtoria e Inspektionit, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av.M.SH. nga Peja, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.414/14, të datës 30.01.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.01.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit J. (I) K. nga Peja, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.414/14, i datës 30.01.2016, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar C.nr.414/14, të datës 30.01.2016, e ka refuzuar kërkespadinë e paditësit J. (I) K. nga Peja, përmes të cilës ka kërkuar nga e paditura Komuna e Pejës (Drejtoria e Inspektionit), që në emër të kompensimit të dëmit për shkak të rrënimin të objektit, t'ia paguaj shumën prej 15.395,60 euro, me kamatë 4% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe që me shpenzimet e saj të bëjë largimin e tërë materialit ndërtimor nga ngastra kadastrale nr.1728/2, në sipërfaqe prej 00.2.00 ha dhe atë lokal në sipërfaqe prej 96 m<sup>2</sup>, etazhitetit 1+NK dhe oborr në sipërfaqe prej 104 m<sup>2</sup> nga lista poseduese nr.11 ZK Vitomicë, si dhe ta kthejnë në pronësi, posedim të qetë dhe shfrytëzim të papenguar të paluajtshmërisë së lartpërmendur si dhe pagesën e shpenzimeve procedurale, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Me pikën II të aktgjykimit, është detyruar paditësi J. (I) K., që të paditurës në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguaj shumën prej 779 euro, në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërçënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, si dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoi ankesën e tij si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar, apo që të njëjtin aktgjykim ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditësit, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 20.05.2014, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi për shkak të kompensimit të dëmit, kundër të paditurës, me arsye sikurse në padi.

Duke vendosur sipas padisë së paditësit, Gjykata e Themelore në Pejë ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.414/14, të datës 30.01.2016, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimin ka theksuar se pas administrimit të provave të propozuara, është ardhur në përfundim se kërkespadija e paditësit është e pabazuar, për arsye se nga të gjitha vendimet dhe konkluzat e lëshuara nga e paditura në rastin konkret, paditësi ka qenë i udhëzuar me klauzolën e udhëzimit juridik në mënyrë që ta shfrytëzoj të drejtën e tij të ankesës, në afatin e paraparë me ligj, për t'iu drejtuar ministrisë përkatëse, të cilën të drejtë ai nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk e ka atakuar asnjë vendim të nxjerrë nga e paditura, çështje kjo e cila i atribuohet ekskluzivisht procedurës administrative, e që i tejkalon kompetencat e vlerësimit në kontest civil. Në vijim gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk i ka marrë fare në vlerësim provat të cilat kanë të bëjnë me lartësinë e dëmit, pasi që baza juridike e padisë ka qenë e pa themeltë, për faktin se ka munguar përgjegjësia juridiko-civile e të paditurës, sepse veprimeve të ndërmarra nga ana e saj nuk mund t'iu atribuohet përgjegjësia për kompensim duke pasur parasysh se të njëjtat veprime e paditura i ka ndërmarrë në procedurën e paraparë ligjore dhe me anë të aktvendimit e ka detyruar paditësin që ta kthej në gjendjen e mëparshme objektin në të cilin i ka ndërmarrë veprimet e renovimit, ku më pastaj e paditura me anë të aktvendimit ka dhënë urdhër që të bëhet edhe rrënimi i ndërtimeve të bëra nga paditësi. Këto vendime nuk janë atakuar nga ana e paditësit, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga e paditura, kështu që janë bërë të formës së prerë, për çka paditësi me mos veprimin e tij dhe mos ankimimin e atyre vendimeve, është pajtuar me veprimet e të paditurës. Mbi bazën e të lartcekurave e duke marrë për bazë nenin 136 dhe 140 të Ligjit mbi Mardhëniet e Detyrimeve (LMD), gjykata e shkallës së parë ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, pasi që ka gjetur se në rastin konkret në veprimet e

të paditurës mungojnë elementet e fajësisë. Në raport me shpenzimet procedurale, gjykata ka vendosur në pajtim me nenin 449, 452 dhe 463 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Andaj pretendimet e paditësit mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pathemelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave materialo - juridike nga edhe ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Me nenin 136 të LMD parashihet se *“kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Zbatimi i kësaj dispozite në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pabazuar, pasi që me asnjë provë konkrete nuk është arritur të provohet fakti se e paditura i ka shkaktuar paditësit dëmin e pretenduar, për çka edhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitën e nenit 452.1 të LPK.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paditësit, por ka gjetur se të njëjtat kanë qenë të pabazuara, të paargumentuara dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK, u vendosë si më lartë.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.974/16, me datën 16.01.2020**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**